

Vendim (Seancë publike)

1 E mërkurë, 20 shkurt 2019

2 Në Hagë, Holandë

3 Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Kushtetuese

4 [Vendim]

5 [Seancë publike]

6 --- Filloi në orën 12.00 në mesditë

7 FTUESI I GJYQIT: Uluni ju lutem.

8 ADMINISTRATORI I ÇËSHTJES: Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese
9 të Dhomave të Specializuara të Kosovës, Gjykatësja An Pauër-Ford, Kryetare dhe
10 unë; Riaz Haider, Administrator i Çështjes; në çështjen Mahir Hasani kundër
11 Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Dosja nr. KSC-CC-2019-05.

12 GJYKATËSJA PAUËR-FORD: Ky shqiptim është një përmbledhje e vendimit të
13 Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Dhoma") mbi Referimin që zoti
14 Mahir Hasani ("Parashtruesi") i ka paraqitur Dhomës më 15 janar 2019
15 ("Referimi"), në bazë të nenit 113 paragrafi (7) të Kushtetutës së Republikës
16 së Kosovës ("Kushtetuta"). Parashtruesi përfaqësohej nga dr. Artan Qerkini.

17 Pas njoftimit të Dhomës për Administratoren më 13 shkurt 2019 në lidhje
18 me datën e shqiptimit të këtij vendimi, publiku u informua paraprakisht për
19 datën dhe orën e tij. Teksti i këtij shqiptimi gjendet në faqen e internetit të
20 Dhomave të Specializuara të Kosovës, në tri gjuhët zyrtare të këtij
21 institucioni.

22 Në Referimin e tij të datës 15 janar 2019, Parashtruesi bën ankesë se
23 Urdhri i Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("Urdhri") që e urdhëron atë, si i
24 dyshuar, të paraqesë dokumente dhe informacione të caktuara, cenon të drejtën e
25 tij për të heshtur dhe shkel privilegjin e mosinkriminimit të vetvetes sipas

Vendim (Seancë publike)

1 nenit 30 paragrafi (6) të Kushtetutës. Ai gjithashtu pretendon se Urdhri cenon
2 të drejtën e
3 tij për t'u prezumuar i pafajshëm sipas nenit 31 paragrafi (5) të Kushtetutës
4 dhe nenit 6 paragrafi (2) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të
5 Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa").

6 Parashtruesi bëri kërkesë në bazë të rregullës 21, paragrafët (1) dhe (2)
7 të Rregullores së Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese
8 ("Rregullorja e Punës"), për një masë të përkohshme për pezullimin e Urdhrit
9 deri në marrjen e vendimit nga Dhoma, në lidhje me Referimin.

10 Më 15 janar 2019, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, në bazë të nenit
11 33 paragrafi (3) të ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e
12 Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), caktoi një panel të Dhomës Kushtetuese
13 për t'u shprehur në lidhje me Referimin.

14 Më 18 janar 2019, Dhoma e lejoi Prokurorin e Specializuar të paraqiste
15 parashtrimin e tij, në përgjigje të kërkesës së Parashtruesit për masë të
16 përkohshme. Prokurori i Specializuar e paraqiti parashtrimin e tij më 25 janar
17 2019.

18 Më 7 shkurt 2019, Dhoma e pezulloi Urdhrin, duke qenë se e detyronte
19 Parashtruesin të paraqesë dokumentet, të dhënat, shënimet dhe informacionet e
20 specifikuara në të. Dhoma konfirmoi se pezullimi i Urdhrit prej saj, nuk
21 paragjykonte vendimin e saj në lidhje me Referimin. Gjithashtu, Dhoma konfirmoi
22 se pezullimi i Urdhrit nuk paragjykonte detyrimin e Parashtruesit për t'u
23 paraqitur për marrje në pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar më 11
24 shkurt 2019.

25 Më 15 shkurt 2019, Prokurori i Specializuar dorëzoi një Njoftim për

Vendim (Seancë publike)

1 Tërheqje të Urdhrit dhe Kërkesë për Hedhjen Poshtë të Referimit.

2 Pas shpalljes së vendimit në lidhje me kërkesën e Parashtruesit për masë
3 të përkohshme, ky shqiptim përmbledh vendimin e Dhomës në lidhje me aspektin
4 material të Referimit. Gjithashtu, në të jepet edhe përgjigjja e Dhomës ndaj
5 Kërkesës së Prokurorit të Specializuar për hedhjen poshtë të Referimit.

6 Paneli Kushtetues i përbërë nga gjykatëse An Pauër-Ford, kryetare, dhe
7 gjykatësit Vidar Stensland dhe Roland Dekers, pas kuvendimeve kokë më kokë dhe
8 në largësi përmes mjeteve elektronike, nxori konstatimet e veta mbi Referimin.

9 Historik i shkurtër i fakteve

10 Më 20 dhjetor 2018, Zyra e Prokurorit të Specializuar i dorëzoi
11 Parashtruesit dy dokumente, përkatësisht një fletëthirrje për t'u paraqitur për
12 marrje në pyetje më 11 shkurt 2019 ("Fletëthirrja") dhe Urdhrin për t'i
13 dorëzuar Zyrës së Prokurorit të Specializuar dokumente dhe informacione të
14 caktuara në të njëjtën ditë.

15 Në Urdhër thuhej se Parashtruesi ishte "i detyruar të paraqiste"
16 dokumente dhe informacione të caktuara të specifikuar në të. Urdhri gjithashtu
17 paralajmëronte se mosparaqitja e dokumenteve do të konsiderohej "mosbindje" dhe
18 si rezultat i kësaj Zyra e Prokurorit të Specializuar mund të kërkonte marrjen
19 e masave që siguronin bindjen ndaj Urdhrit.

20 Urdhri gjithashtu konfirmonte se ekzistonin arsye për të besuar që
21 Parashtruesi ishte përfshirë në kryerjen e një krimi brenda juridiksionit të
22 Dhomave të Specializuara të Kosovës.

23 Juridiksioni

24 Në Referimin e paraqitur në bazë të nenit 113 paragrafi (7) të
25 Kushtetutës, Parashtruesi bën ankesë në lidhje me Urdhrin e lëshuar nga Zyra e

Vendim (Seancë publike)

1 Prokurorit të Specializuar. Pra, Referimi ka të bëjë me Dhomat e Specializuara
2 dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, ashtu siç e kërkon neni 162 paragrafi
3 (3) i Kushtetutës dhe nenet 3 paragrafi (1) dhe neni 49 paragrafi (2) të
4 Ligjit. Rrjedhimisht, Dhoma ka juridiksion të marrë vendim mbi Referimin.

5 Konstatimet

6 *Reflektime paraprake mbi Ligjin*

7 Në fillim, Dhoma rikujton detyrën e vet për mbikëqyrjen e punës së
8 Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës
9 lidhur me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

10 Për sa i përket të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në
11 Kapitullin II të Kushtetutës, neni 22 paragrafi (2) i saj, parashikon zbatimin
12 e drejtpërdrejtë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu,
13 sipas nenit 53, të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë,
14 duhen interpretuar në një mënyrë që është në përputhje me vendimet e Gjykatës
15 Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

16 Bazuar në sa më sipër, gjatë shqyrtimit të këtij Referimi, Dhoma ka
17 mbajtur parasysh në veçanti jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut.

18 *Shkeljet e pretenduara*

19 Referimi i Parashtruesit ka të bëjë me të drejtën për të heshtur dhe
20 privilegjin e mosinkriminimit të vetvetes, sikurse garantohen në nenin 30
21 paragrafi (6) të Kushtetutës dhe nenin 6 paragrafi (1) të Konventës. Referimi
22 ngre pyetjen nëse ato garanci janë të zbatueshme edhe për fazën hetimore të
23 procedurës penale dhe në veçanti, për rrethanat në të cilat autoritetet e
24 urdhërojnë një të dyshuar të konfirmuar që të paraqesë dokumente dhe
25 informacione gjatë hetimit penal.

Vendim (Seancë publike)

1 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka konfirmuar se garancitë që
2 ofron neni 6 paragrafi (1) dhe (3) i Konventës janë të zbatueshme për një
3 person që është objekt i një "akuze penale". Neni 30 i Kushtetutës gjithashtu
4 parashikon të drejtat minimale të një personi "të akuzuar për vepër penale".
5 Gjykata e Strasburgut përdor qasjen materiale përkundër asaj formale për t'i
6 dhënë përgjigje
7 pyetjes se kur një person mund të konsiderohet objekt i një akuze penale. Në
8 vitin 2016, në çështjen *Ibrahim dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*,
9 Dhoma e Madhe e Gjykatës së Strasburgut miratoi qasjen e përdorur më herët në
10 *Aleksandër Zaiçenko kundër Rusisë*, ku Gjykata kishte shpjeguar se nëse ekziston
11 dyshimi që një person ka kryer vepër penale, ai person konsiderohet se është
12 objekt i një 'akuze' në kuptim të nenit 6 të Konventës.

13 Mbi këtë bazë, Dhoma vëren se Urdhri i lëshuar konfirmonte që ndaj
14 Parashtruesit ekzistonte një dyshim. Duke pasur parasysh këtë konfirmim, Dhoma
15 mendon se neni 30 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës, në veçanti e drejta për
16 të heshtur dhe privilegji për të mos inkriminuar vetveten, në rastin e
17 Parashtruesit vepronin dhe ishin të zbatueshëm.

18 Dhoma rikujton se qëllimi i së drejtës për të heshtur dhe i privilegjit
19 të mosinkriminimit të vetvetes është që të mbrojë personin e akuzuar nga
20 detyrimi i palejueshëm prej autoriteteve dhe rrjedhimisht shmangë mohimin e
21 drejtësisë. Është ekzistenca e detyrimit ajo që ngre çështjen nëse është
22 respektuar privilegji i mosinkriminimit të vetvetes.

23 Dhoma është bindur se sipas kushteve të Urdhrit të lëshuar, ekzistonte
24 një element i qartë detyrimi. Ai përbëhej nga një *paralajmërim* se nëse
25 Parashtruesi nuk do t'i paraqiste dokumentet e specifikuar, kjo mosparaqitje

Vendim (Seancë publike)

1 do të konsiderohej 'mosbindje'. Kërcënimi se do të nisej procedim ligjor për të
2 detyruar zbatimin, nëse Parashtruesi nuk do t'i paraqiste dokumentet, e
3 forconte edhe më tej elementin e detyrimit. Dhoma e mendon të përshtatshme të
4 rikujtojë dy aspekte të juridiksionit të Gjykatës së Strasburgut që lidhen me
5 pasojat e një detyrimi të tillë.

6 Aspekti i parë lidhet me përdorimin e mëvonshëm në gjykim të
7 informacionit të
8 përftuar nën kërcënim. Ai ka të bëjë me raste si ai *Sonders kundër Mbretërisë*
9 *së Bashkuar*, ku një i dyshuar jep dëshmi si rezultat i kërcënimit për marrje
10 masash ndëshkimore dhe dëshmia përdoret më vonë në gjykimin e atij personi. Në
11 rastin tonë, Parashtruesi argumentoi se në rast se do të ketë gjykim kundër
12 tij, dokumentet dhe të dhënat që ai ishte urdhëruar të paraqiste nën kërcënimin
13 e masës ndëshkimore, më vonë mund ta dëmtonin mbrojtjen e tij dhe t'i jepnin
14 një avantazh të padrejtë Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

15 Dhoma vëren se, ndryshe nga çështja *Sonders kundër Mbretërisë së*
16 *Bashkuar*, në rastin e Parashtruesit nuk është zhvilluar gjykim dhe as nuk ka
17 pasur vendim fajësie. Dhoma nuk mund të hamendësojë nëse Parashtruesi do të
18 përballej me gjykim, nëse do të ishin përdorur dokumentet e specifikuar në
19 Urdhër, nëse Parashtruesi do të ishte shpallur fajtor dhe nëse, si pasojë, do
20 të ishte kompromentuar cilësia e gjykimit në tërësi, nëse do të ishte zhvilluar
21 një i tillë. Nëse Urdhri nuk do të ishte tërhequr, Dhoma është e bindur se ky
22 aspekt i ankesës së Parashtruesit, pra që detyrimi për të paraqitur dokumentet
23 e specifikuar do të kishte ndikuar në drejtësinë e gjykimit, ishte i
24 parakohshëm.

25 Aspekti i dytë në jurisprudencën e Strasburgut lidhet me masat

Vendim (Seancë publike)

1 ndëshkimore që jepen kundër një të dyshuari në qoftë se refuzon të paraqesë
2 informacione të caktuara. Ky problem del në raste si ai *Hini dhe McGinis kundër*
3 *Irlandës*, ku të dyshuarit i kërkohet që të paraqesë informacion nën kërcënimin
4 e masës ndëshkimore dhe në vijim ndëshkohet kur refuzon ta bëjë këtë. Dhoma
5 është e bindur që në një situatë të tillë, përsëri mund të veprojë neni 6 i
6 Konventës, edhe në qoftë se ndaj individit nuk ngrihet aktakuzë në bazë të
7 procedurës fillestare, ose në qoftë se shpallet i pafajshëm pas gjykimit, nëse
8 do të ketë një të tillë.

9 Sipas argumentimit të Parashtruesit, Urdhri përbënte një detyrim të
10 palejueshëm për t'i dhënë Zyrës së Prokurorit të Specializuar prova potenciale,
11 sepse përmbante paralajmërimin se mosparaqitja e dokumenteve nga Parashtruesi
12 do të konsiderohej mosbindje, si edhe kërcënimin se si rezultat i kësaj mund të
13 merreshin masa për të siguruar bindjen ndaj Urdhrit. Duke pasur parasysh këto
14 kushte të Urdhrit të lëshuar, Dhoma rikujton se në *Hini dhe McGinis kundër*
15 *Irlandës*, Gjykata e Strasburgut konstatoi shkelje të e nenit 6 të Konventës në
16 rrethanat kur, gjatë kryerjes së një hetimi penal, parashtruesve që ishin të
17 dyshuar u ishte kërkuar nën kërcënimin e masave ndëshkimore t'u jepnin
18 punonjësve të policisë informacione të caktuara. Të dyshuarit kishin refuzuar
19 ta bënin një gjë të tillë dhe në vijim autoritetet i kishin ndjekur ata
20 penalisht për mosdhënien e informacionit.

21 Duke u bazuar në atë jurisprudencë, për Dhomën është e qartë natyra e
22 palejueshme e Urdhrit të lëshuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Nëse
23 kundër Parashtruesit do të kishte që konstatim mosbindjeje për shkak të
24 ushtrimit të të drejtave të tij kushtetuese dhe nëse ndaj tij do të ishin masa
25 detyruese sepse e kishte bërë këtë, atëherë sipas të gjitha gjasave kjo do të

Vendim (Seancë publike)

1 kishte çuar në një situatë të palejueshme sipas nenit 30 paragrafi (6) të
2 Kushtetutës dhe nenit 6 paragrafi (1) të Konventës.

3 Për ruajtjen e të drejtave kushtetuese të Parashtruesit për të heshtur
4 dhe për të mos inkriminuar veten, më 7 shkurt 2019 Dhoma e pezulloi Urdhrin e
5 lëshuar, duke qenë se e *detyronte* Parashtruesin të paraqiste dokumentet dhe
6 informacionet e specifikuara në të. Masa e përkohshme siguroi ruajtjen e
7 statukuosë deri në marrjen e vendimit për Referimin. Ajo siguroi gjithashtu që
8 ndaj Parashtruesit nuk mund të bëhej konstatim për mosbindje dhe nuk mund të
9 merreshin masa detyruese, në qoftë se do të kishte zgjedhur të ushtronte të
10 drejtën e tij për të heshtur dhe për të mos
11 inkriminuar vetveten kur të paraqitej për marrje në pyetje më 11 shkurt 2019.

12 Pasi e shqyrtoi rastin e Parashtruesit, Dhoma është bindur se, siç
13 paraqitet situata tani, ndaj Parashtruesit nuk ekziston asnjë konstatim për
14 mosbindje dhe as nuk janë marrë masa detyruese për mosparaqitjen e dokumenteve
15 të specifikuara në Urdhrin e lëshuar. Në qoftë se do të ishin nisur procedura
16 të tilla, atëherë mund të ishte ngritur çështja lidhur me të drejtën për të
17 heshtur dhe privilegjin e mosinkriminimit, edhe sikur statusi i Parashtruesit
18 të mos ndryshonte nga i dyshuar në të akuzuar.

19 Zhvillime të mëvonshme

20 Dhoma vëren se më 15 shkurt 2019, Prokurori i Specializuar dorëzoi një
21 njoftim për Tërheqjen e Urdhrit që është objekt i këtij Referimi, si edhe një
22 Kërkesë për Hedhjen Poshtë të Referimit në fjalë.

23 Në mbështetje të Kërkesës së tij, Prokurori i Specializuar argumentonte
24 se duke e tërhequr Urdhrin, rrethanat për të cilat bën ankesë Parashtruesi
25 pushojnë së ekzistuari. Ai argumentonte më tej se çdo pasojë e mundshme e

Vendim (Seancë publike)

1 ndonjë shkelje të pretenduar të të drejtave të Parashtruesit tashmë është
2 ndrequr, së pari përmes masës së përkohshme të urdhëruar nga kjo Dhomë dhe së
3 dyti, si rezultat i tërheqjes së Urdhrit nga ana e Prokurorit të Specializuar.

4 Në lidhje me këtë, Dhoma rikujton se Gjykata Evropiane e të Drejtave të
5 Njeriut ka konfirmuar se, në parim, një vendim ose masë në favor të një
6 Parashtruesi nuk është e mjaftueshme për t'i hequr atij statusin e viktimës,
7 përveç nëse autoritetet shtetërore e kanë pranuar, goftë shprehimisht apo në
8 thelb, dhe kanë ndërmarrë në vijim masa ndreqëse në lidhje me shkeljen e
9 Konventës.

10 Megjithatë, Dhoma është e mendimit se në këtë fazë të hershme të
11 procedurës nuk kërkohet të merret në shqyrtim mjaftueshmëria e pranimit apo e
12 masës ndreqëse,
13 veçanërisht në rrethanat kur Referimi i Parashtruesit nuk ishte deklaruar i
14 pranueshëm përpara tërheqjes së Urdhrit.

15 Dhoma është e mendimit se në përcaktimin nëse një çështje duhet të hidhet
16 poshtë, ajo mund të marrë parasysh ngjarjet që ndodhin pas dorëzimit të
17 Referimit. Për Dhomën, çështja nëse Parashtruesi mund të pretendojë ende se
18 është viktimë e shkeljeve të pretenduara të të drejtave të tij kushtetuese, në
19 thelb do të thotë se duhet të merren parasysh realitetet e situatës së tij. Kjo
20 do të thotë gjithashtu se zhvillimet e ndodhura që prej dorëzimit të Referimit
21 duhet patjetër të shqyrtohen.

22 Në shqyrtimin e të gjitha rrethanave të rastit të Parashtruesit, Dhoma
23 vëren se ai i ka kërkuar kësaj Dhome ta anulojë Urdhrin e lëshuar, ose në
24 alternativë (hap citimin) "*të urdhërojë Zyrën e Prokurorit të Specializuar të*
25 *anulojë të njëjtin Urdhër*" (mbyll citimin). Dhoma është bindur se me dorëzimin

Vendim (Seancë publike)

1 e Njoftimit për Tërheqje të Urdhrit, Prokurori i Specializuar në fakt dhe me
2 vullnetin e tij, e ka tërhequr Urdhrin. Kjo masë e ka kthyer faktikisht
3 Parashtruesin në gjendjen që ishte para se të lëshohej Urdhri.

4 Në këto rrethana, Dhoma nxjerr përfundimin se për Parashtruesin nuk
5 ekziston më arsye objektive për të proceduar më tej me Referimin.

6 Dhoma është bindur se me tërheqjen e Urdhrit, rrethanat e kundërshtuara
7 nga Parashtruesi nuk qëndrojnë më. Po kështu, Dhoma është bindur se pasojat e
8 ndonjë shkelje të mundshme të të drejtave kushtetuese të Parashtruesit, si
9 pasojë e Urdhrit të lëshuar, janë shmangur.

10 Rrjedhimisht, Parashtruesi nuk mund të pretendojë më se është viktimë e
11 shkeljeve të pretenduara të të drejtave të tij kushtetuese.

12 Përfundime

13 Dhoma është e mendimit se në situatën e Parashtruesit *hynin në veprim* e
14 drejta për të heshtur dhe privilegji i mosinkriminimit të vetvetes në bazë
15 nenit 30 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës, sipas kushteve të Urdhrit të
16 lëshuar. Në pamje të parë Urdhri ishte problematik, duke qenë se e *detyronte*
17 Parashtruesin, një i dyshuar i konfirmuar, që të paraqiste dokumentet dhe
18 informacionet dhe e paralajmëronte atë për konstatim *mosbindjeje* dhe për masa
19 të mundshme detyruese në rast se nuk do t'i paraqiste dokumentet.

20 Në përputhje me nenin 49 paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit, detyra e kësaj
21 Dhome është të vlerësojë nëse rrethanat për të cilat ankohet Parashtruesi
22 cenonin të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë.
23 Nuk është roli i kësaj Dhome të trajtojë gabimet e pretenduara të bëra gjatë
24 procedurës penale, përveç dhe vetëm nëse këto gabime mund të kenë të bëjnë me
25 një shkelje të drejtave dhe lirive të garantuara në Kushtetutë. Ankesat në

Vendim (Seancë publike)

1 rastin në fjalë ngritën çështje të rëndësishme në lidhje me shkelje të
2 pretenduara të të drejtave të Parashtruesit sipas Kushtetutës për shkak të
3 Urdhrit të lëshuar.

4 Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se të drejtat kushtetuese të
5 Parashtruesit për të heshtur dhe për të mos inkriminuar vetveten u ruajtën
6 përmes masës së përkohshme kur ai u paraqit për t'u marrë në pyetje më 11
7 shkurt 2019, si dhe duke pasur parasysh që Prokurori i Specializuar në vijim e
8 tërhoqi Urdhrin e lëshuar, Dhoma është bindur se Parashtruesi nuk mund të
9 pretendojë më se është viktimë e shkeljeve të pretenduara sipas nenit 30
10 paragrafi (6) të Kushtetutës dhe nenit 6 paragrafi (1) të Konventës.

11 Ky konstatim qëndron gjithashtu edhe në lidhje me shkeljen e pretenduar
12 të nenit 31 paragrafi (5) të Kushtetutës dhe nenit 6 paragrafi (2) të
13 Konventës, sipas së cilës Parashtruesi ankohej se Urdhri i lëshuar cenonte
14 prezumimin e pafajësisë duke bartur barrën e provës tek ai.

15 Duke qenë se Urdhri që përbën bazën e ankesës së Parashtruesit është
16 tërhequr, Referimi duhet të deklarohej i papranueshëm në bazë të rregullës 14
17 paragrafi (f) të Rregullores së Punës.

18 Në bazë të rregullës 21 paragrafi (6) të Rregullores së Punës dhe duke
19 mbajtur parasysh tërheqjen e Urdhrit nga ana e Prokurorit të Specializuar, masa
20 e përkohshme e urdhëruar më 7 shkurt 2019 pushon së vepruari menjëherë.

21 Ky Vendim mbi Referimin hyn në fuqi menjëherë.

22 Vendim

23 Pas dhënies së kësaj përmbledhjeje të vendimit të Dhomës, dispozitat
24 operative të Vendimit të saj janë si vijon:

25 PËR KËTO ARSYE,

Vendim (Seancë publike)

1 Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, njëzëri,
2 *E deklaron* Referimin, në lidhje me Urdhrin e Zyrës së Prokurorit të
3 Specializuar të datës 20 dhjetor 2018, të papranueshëm.

4 Këtu përfundon shqiptimi i vendimit të Dhomës.

5 FTUESI I GJYQIT: Të gjithë në këmbë.

6 Pas kësaj, seanca u mbyll në orën 12.22, në mesditë.

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25